



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I MINISTRAVE

PROJEKTVENDIM

Nr. \_\_\_\_\_, datë \_\_\_\_\_. \_\_\_\_\_. 2020

PËR

**PËRCAKTIMIN E MASËS SË KOMPENSIMIT TË DËMEVE, PROCEDURAVE, AFATEVE, STRUKTURAVE SHTETËRORE PËRGJEGJËSE PËR VLERËSIMIN E DËMEVE, SI DHE TË PASURIVE TË SUBJEKTEVE QË KOMPENSOHEN PËR DËMET QË SHKAKTOHEN SI PASOJË E NJË FATKEQËSIE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës; të pikës 6, të nenit 41, të ligjit nr. 45/2019 “Për mbrojtjen civile”, me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

**V E N D O S I:**

1. Kompensimin financiar të subjekteve të dëmtuara, si rezultat i fatkeqësisë natyrore ose fatkeqësive të tjera, të cilët kanë pësuar humbje të jetës njerëzore dhe/ose kanë pësuar dëm pasuror.
2. Jo më vonë se 5 ditë nga ndodhja e një fatkeqësie natyrore ose fatkeqësie tjetër, me urdhër të kryetarit të bashkisë së prekur ngrihet Komisioni për Evidentimin e Dëmeve.
3. Përbërja e komisionit përcaktohet në varësi të natyrës së fatkeqësisë. Në çdo rast, në përbërje të tij ka jo më pak se 3 anëtarë. Kur kapacitetet njerëzore janë të pamjaftueshme, njësi e vetëqeverisjes vendore kërkon kapacitete shtesë nga bashkitë fqinje apo nga struktura të tjera shtetërore, sipas natyrës së fatkeqësisë.
4. Detyrat e Komisionit për Evidentimin e Dëmeve janë:
  - a) verifikimi në terren i dëmeve të shkaktuara në zonën e prekur nga fatkeqësia;
  - b) mbajtja e procesverbaleve të evidentimit të dëmeve për secilin subjekt përfitues;
  - c) në përfundim të 15 ditëve nga ngritja e tij, njoftimi i kryetarit të bashkisë dhe dorëzimi pranë tij i procesverbaleve;
  - ç) çdo detyrë tjetër që lidhet me natyrën e fatkeqësisë dhe qëllimin për të cilin është ngritur, me kushtin që të përmenden në urdhrin përkatës për ngritjen e tij.
5. Evidentimi i dëmeve do të përfshijë dëmet në objekte private banimi ose objekte ku ushtrohet aktivitet ekonomik, orendi, mobilie, pajisje elektroshtëpiake, kultura dhe njësi bujqësore e blegtorale, në pronësi të subjektit të dëmtuar dhe të dokumentuara, sipas akteve ligjore e nënligjore në fuqi.

6. Në përfundim të procesit të evidentimit të subjekteve dhe të dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësia natyrore ose fatkeqësia tjetër, por jo më vonë se 15 ditë nga ngritja e tij, Komisioni për Evidentimin e Dëmeve dorëzon dokumentacionin e përgatitur pranë kryetarit të bashkisë.
7. Jo më vonë se tri ditë, pasi përfundon punën Komisioni për Evidentimin e Dëmeve, me urdhër të kryetarit të bashkisë, në territorin e së cilës ka ndodhur fatkeqësia, ngrihet Komisioni për Vlerësimin e Dëmeve. Komisioni ka në përbërje jo më pak se tre anëtarë, një prej të cilëve të jetë në profilin financë.
8. Komisioni për Vlerësimin e Dëmeve bën vlerësimin e dëmeve sipas kategorive, më poshtë:
  - a) Vlerësimi i dëmeve ndërtimore për objektet private të banimit bëhet:
    - i. në rastet e shkatërrimit total të tyre, sipas kostos mesatare të ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i Banesave, për vitin përkatës;
    - ii. në rastet e tjera, me çmimet në fuqi, sipas zërave të punimeve të ndërtimit, miratuar nga Këshilli i Ministrave për Entin Kombëtar të Banesave, për qytetin përkatës.
  - b) Vlerësimi i dëmeve ndërtimore për objektet ku ushtrohet aktivitet ekonomik dhe/ose objektet private me karakter bujqësor e blegtoral bëhet sipas kostos mesatare të ndërtimit, të miratuar nga aktet ligjore e nënligjore në fuqi.
  - c) Vlerësimi i dëmeve për orenditë, mobiliet dhe pajisjet elektroshtëpiake, të dëmtuara në objektet e banimit bëhet mbi bazën e çmimeve aktuale mesatare, të përcaktuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve.
  - ç) Vlerësimi i dëmeve të shkaktuara në kultura bujqësore, mjete mekanike, makineri dhe agregate bujqësore, në gjënë e gjallë dhe në bazën ushqimore (koncentrate, sanë, njomishte etj.) kryhet sipas çmimeve të tregut, të miratuar nga ministria përgjegjëse për bujqësinë.
9. Përcaktimi i kompensimit financiar për dëmet që shkaktohen nga pasojat e një fatkeqësie bëhet, si më poshtë vijon:
  - a) masa e kompensimit financiar që bashkia i akordon familjes në rastin e humbjes së jetës së anëtarit ose anëtarëve të saj, si pasojë e fatkeqësisë, është 500 000 (pesëqind mijë) lekë për çdo person që humb jetën. Në këto raste, masa e kompensimit do t'i akordohet nga bashkia në territorin e së cilës ka ndodhur fatkeqësia, përfaqësuesit të caktuar nga trashëgimtarët testamentarë/ligjorë të personit që ka humbur jetën;
  - b) në rastet e shkatërrimit total të banesave, subjekti do të kompensohet në vlerën 100%, por pa tejkaluar sipërfaqen, bazuar në normativat e strehimit të Entit Kombëtar të Banesave;
  - c) masa e kompensimit financiar për dëmet e ardhura sipas kategorive të tjera, të përmendura në pikën 8 të vendimit, do të jetë 50% e dëmit, sipas konstatimit të komisionit përkatës.
10. Në përfundim të vlerësimit të dëmeve dhe jo më vonë se 20 ditë nga ngritja e tij, Komisioni për Vlerësimin e Dëmeve dorëzon dokumentacionin pranë këshillit të bashkisë, i cili, pasi shqyrton dokumentacionin, merr vendimin për dhënien e kompensimit financiar.
11. Dokumentacioni i nevojshëm vërtetues për dhënien e kompensimit financiar për dëmet që shkaktohen si pasojë e një fatkeqësie janë:
  - a) kërkesa e subjektit të dëmtuar për kompensim financiar;

- b) fotokopje të dokumentit të identifikimit;
  - c) procesverbali i evidentimit të dëmeve, shoqëruar me foto;
  - ç) preventivi i dëmeve nga ana ndërtimore në objektet e banimit;
  - d) preventivi i dëmeve në orendi, mobilie dhe pajisje elektroshtëpiake;
  - dh) preventivi i dëmeve në kultura bujqësore, mjete mekanike, makineri dhe agregate bujqësore, në gjënë e gjallë dhe në bazën ushqimore (koncentrate, sanë, njomishte etj.)
  - e) certifikata e vdekjes së pjesëtarit të familjes, kur ka raste të tilla, shoqëruar me vërtetimin e komisionit mjekoligjor, sipas rastit;
  - ë) certifikatë pronësie ose çdo dokument tjetër i vlefshëm për vërtetimin e pronësisë mbi objektin ndërtimor të dëmtuar;
  - f) vërtetimi nga shërbimi i MZSH-së në bashki, në raste zjarri dhe vërtetimi nga policia e shtetit ose prokuroria e rrethit, në rast eksplozivi;
  - g) vërtetim nga kompania e sigurimit, ku përfshihet vlera e kompensimit që i është dhënë subjektit;
  - gj) vendimi i këshillit të bashkisë për masën e kompensimit financiar.
12. Afati kohor nga data e ndodhjes së fatkeqësisë, deri në përfundimin e gjithë dokumentacionit të vlerësimit të dëmeve për subjektin e dëmtuar do të jetë 45 (dyzet e pesë) ditë.
  13. Për subjektet që kanë sigurim jete dhe/ose prone, pasi bën verifikimet përkatëse pranë të gjitha kompanive të sigurimit, njësia e vetëqeverisjes vendore bën kompensimin e subjektit deri në masën që do të përfitonte, bazuar në vlerësimin e dëmeve.
  14. Në rastet kur ka pamjaftueshmëri fondesh veprohet në përputhje me dispozitat përkatëse të ligjit nr. 45/2019 "Për mbrojtjen civile".
  15. Përrjashtohen nga kompensimi për dëmet e shkaktuara si pasojë e një fatkeqësie, të gjithë subjektet e dëmtuara, kur kompensohen sipas pikës 5, të nenit 41, të ligjit nr. 45/2019 "Për mbrojtjen civile".
  16. Përrjashtohen nga kompensimi të gjithë subjektet që përfitojnë nga njëri prej programeve të rindërtimit.
  17. Kërkesat/dokumentacioni i dërguar në Agjencinë Kombëtare të Mbrojtjes Civile për kompensim dëmi, i shkaktuar si pasojë e një fatkeqësie, para hyrjes në fuqi të këtij vendimi, do të trajtohen sipas vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 329, datë 16.5.2012 "Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore".
  18. Vendimi nr. 329, datë 16.5.2012, i Këshillit të Ministrave, "Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore", shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**

**Edi Rama**

## RELACION

### PËR

### PROJEKTVENDIMIN

#### **“PËR PËRCAKTIMIN E MASËS SË KOMPENSIMIT TË DËMEVE, PROCEDURAVE, AFATEVE, STRUKTURAVE SHTETËRORE PËRGJEGJËSE PËR VLERËSIMIN E DËMEVE, SI DHE TË PASURIVE TË SUBJEKTEVE QË KOMPENSOHEN PËR DËMET QË SHKAKTOHEN SI PASOJË E NJË FATKEQËSIE”**

#### **I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN**

Ky projektvendim ka si qëllim përcaktimin e masës së kompensimit të dëmeve, procedurave, afatet, strukturat shtetërore përgjegjëse për vlerësimin e dëmeve, si dhe pasuritë dhe subjektet që kompensohen për dëmet që shkaktohen si pasojë e një fatkeqësie natyrore ose fatkeqësi të tjera.

Nëpërmjet projektvendimit shfuqizohet vendimi nr. 329, datë 16.5.2012, i Këshillit të Ministrave, “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore”, i cili deri më tani ka shërbyer si dokument bazë për kryerjen e procedurave të dhënies së ndihmës financiare në rastet e fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësive të tjera.

Projektvendimi do të dalë në zbatim të nenit 41, të ligjit nr. 45/2019 “Për mbrojtjen civile”, në përmbajtje të të cilit, ndër të tjera, përcaktohet se “Shteti shqiptar përgjigjet për dëmet që shkaktohen nga pasojat e një fatkeqësie” dhe se “Masa e kompensimit të dëmeve, procedurat, afatet, strukturat shtetërore përgjegjëse për vlerësimin e dëmeve, si dhe pasuritë dhe subjektet që kompensohen miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave.”

#### **II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE**

Projektvendimi ka karakter teknik dhe nuk lidhet me programin politik të Këshillit të Ministrave dhe as me dokumente të tjera politike.

Projektvendimi është parashikuar në programin e përgjithshëm analitik të projektakteve, që do të paraqiten për shqyrtim në Këshillin e Ministrave, për vitin 2020. Miratimi i këtij projektvendimi është detyrim ligjor që rrjedh nga pika 6, e nenit 41, të ligjit nr. 45/2019 “Për mbrojtjen civile”.

---

Relacion shpjegues për projektvendimin “Për përcaktimin e masës së kompensimit të dëmeve, procedurave, afateve, strukturave shtetërore përgjegjëse për vlerësimin e dëmeve, si dhe të pasurive të subjekteve që kompensohen për dëmet që shkaktohen si pasojë e një fatkeqësie.”

### **III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME**

Ligji nr. 45/2019 “Për mbrojtjen civile” përcakton se në rastet kur një fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi tjetër shkakton humbje jetësh njerëzore dhe/ose dëme pasurore, shteti shqiptar i ofron kompensim financiar të dëmtuarit.

Fondet për kompensimin financiar do të mbulohen në mënyrë të përshkallëzuar nga fondet e kushtëzuara të buxhetit të shtetit për mbrojtjen civile, duke filluar nga njësitë e vetëqeverisjes vendore, organet e qeverisjes qendrore dhe në rast pamjaftueshmërie, me përdorimin e fondit rezervë të Këshillit të Ministrave. Dëmet e ardhura nga fatkeqësia natyrore apo fatkeqësitë e tjera do të përballohen nga organet e vetëqeverisjes vendore në territorin e së cilës ka ndodhur fatkeqësia, nëpërmjet përdorimit të fondit të sipërpërmendur.

Akordimi i kompensimit financiar në një kohë sa më të shpejtë për subjektet e dëmtuara ka qenë dhe do të vazhdojë të jetë me rëndësi të madhe për ardhjen në ndihmë financiare për dëmet e shkaktuara si pasojë e një fatkeqësie natyrore ose një fatkeqësie tjetër.

Miratimi i projektvendimit rrjedh si detyrim nga ligji i sipërpërmendur, i cili me hyrjen në fuqi shfuqizoi ligjin nr. 8756, datë 26.3.2001 “Për emergjencat civile”, i ndryshuar, e për pasojë edhe aktet nënligjore të nxjerra në zbatim të tij.

Me miratimin e këtij projektvendimi, vendimi nr. 329, datë 16.5.2012, i Këshillit të Ministrave “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore”, dalë në zbatim të ligjit nr. 8756, datë 26.03.2001 “Për emergjencat civile”, i ndryshuar, shfuqizohet.

Projektvendimi synon të përcaktojë qartë institucionet shtetërore në nivel vendor dhe qendror, të cilët ngarkohen me evidentimin e dëmeve që vijnë si pasojë e një fatkeqësie, vlerësimin financiar të dëmeve dhe përcaktimin e masës së kompensimit të dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore apo nga fatkeqësitë e tjera, duke iu referuar akteve të tjera normative të miratuara për përlllogaritjen e vlerave financiare të objekteve apo pasurive të dëmtuara nga fatkeqësitë.

Projektvendimi synon të unifikojë procedurat dhe kriteret e evidentimit të dëmeve dhe përcaktimin e shumës financiare për kompensimin e dëmit.

### **IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR**

Ky projektvendim është në harmoni të plotë me rendin e brendshëm juridik dhe atë ndërkombëtar. Projektvendimi propozohet në bazë të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 6, të nenit 41, të ligjit nr. 45/2019 “Për mbrojtjen civile”.

---

Relacion shpjegues për projektvendimin “Për përcaktimin e masës së kompensimit të dëmeve, procedurave, afateve, strukturave shtetërore përgjegjëse për vlerësimin e dëmeve, si dhe të pasurive të subjekteve që kompensohen për dëmet që shkaktohen si pasojë e një fatkeqësie.”

## V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME *ACQUIS* TË BE

Projektvendimi nuk synon përafrimin me legjislacionin komunitar.

## VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Projektvendimi del në zbatim të pikës 6, të nenit 41, të ligjit nr. 45/2019 “Për mbrojtjen civile” dhe përbëhet nga 18 pika që përcaktojnë, si më poshtë:

Sipas pikës së parë të projektvendimit, subjekteve të dëmtuara, si rezultat i fatkeqësisë natyrore ose fatkeqësive të tjera, do t’i ofrohet kompensim financiar nga ana e shtetit shqiptar.

Sipas pikës së dytë, procedura për kompensimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësitë do të nisë me ngritjen e Komisionit për Evidentimin e Dëmeve. Me qëllim shmangien e vonesave dhe realizimin e një reagimi të menjëhershëm dhe ardhjen sa më shpejt në ndihmë subjekteve të dëmtuara nga fatkeqësia është vendosur një afat maksimal pesë ditor për ngritjen e komisionit.

Në pikat tre dhe katër përcaktohen detyrat dhe përbërja e komisionit, duke theksuar që komisioni duhet të ketë në përbërje të paktën 3 anëtarë dhe duke mos e limituar numrin maksimal për shkak edhe të faktit që është e pamundur të parashikohen pasojat që mund të vijnë nga një fatkeqësi, e për rrjedhojë as numri i ekspertëve apo anëtarëve që do të duhet të përfshijë komisioni. Bazuar në nenin 7, të ligjit nr. 45/2019 “Për mbrojtjen civile”, sipas parimit të subsidiaritetit, përcaktohet që në rast të pamjaftueshmërisë së kapaciteteve (në këtë rast të burimeve njerëzore) të strukturës së qeverisjes vendore, njësia e vetëqeverisjes vendore kërkon kapacitete shtesë nga bashkitë fqinje apo nga struktura të tjera shtetërore sipas natyrës së fatkeqësisë. Gjithashtu, është lënë e hapur mundësia për të përfshirë detyra të tjera për komisionin, me kushtin që këto detyra të përfshihen në urdhrin e kryetarit, duke marrë në konsideratë natyrën konkrete të fatkeqësisë dhe pasojave që mund të ketë shkaktuar.

Sipas pikës pesë, evidentimi dhe vlerësimi financiar i dëmeve të shkaktuara, si pasojë e një fatkeqësie do të bëhet për dëmet në objekte private banimi, objekte ku ushtrohet aktivitet ekonomik, orendi, mobilie, pajisje elektroshtëpiake dhe kultura bujqësore e blegtorale, për të cilat do të kompensohet titullari i të drejtës së pronësisë.

Pika gjashtë e projektvendimit vendos një afat maksimal për përfundimin e punës së Komisionit për Evidentimin e Dëmit, duke përcaktuar se “Në përfundim të procesit të evidentimit të subjekteve dhe të dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësia natyrore ose fatkeqësia tjetër, por jo më vonë se 15 ditë nga ngritja e tij, Komisioni për Evidentimin e Dëmeve dorëzon dokumentacionin e përgatitur pranë kryetarit të bashkisë”.

Në pikën shtatë të projektvendimit gjithashtu përcaktohet se jo më vonë se tri ditë, pasi Komisioni për Evidentimin e Dëmeve përfundon punën, kryetari i bashkisë, në territorin e së cilës ka ndodhur fatkeqësia, ngre Komisionin për Vlerësimin e Dëmeve. Duke qenë se

---

Relacion shpjegues për projektvendimin “Për përcaktimin e masës së kompensimit të dëmeve, procedurave, afateve, strukturave shtetërore përgjegjëse për vlerësimin e dëmeve, si dhe të pasurive të subjekteve që kompensohen për dëmet që shkaktohen si pasojë e një fatkeqësie.”

vlerësimi i dëmeve përfshin, por nuk limitohet vetëm te vlerësimi financiar, është vlerësuar e domosdoshme përcaktimi që të paktën njëri prej anëtarëve të jetë ekspert në financë.

Pika tetë e projektvendimit përcakton rastet kur subjekti do të kompensohet, konkretisht:  
Për dëme në objektet private të banimit, kur shkatërrohen plotësisht ose pjesërisht;  
Për dëme në objektet ku ushtrohet aktivitet ekonomik dhe/ose në objektet private me karakter bujqësor e blegtoral;  
Për dëmet e shkaktuara në orenditë, mobiliet dhe pajisjet elektroshtëpiake;  
Për dëmet e shkaktuara në kultura bujqësore, mjete mekanike, makineri dhe agregate bujqësore, në gjënë e gjallë dhe në bazën ushqimore (koncentrate, sanë, njomishte etj.).

Në pikën nëntë përcaktohet masa e kompensimit për secilin rast, ku:

Në rastet e humbjes së jetëve njerëzore është caktuar shuma prej 500 000 lekë për çdo person që ka humbur jetën; Gjithashtu, për efekt procedure është parashikuar që masa e kompensimit të kalojë në llogarinë e një përfaqësuesi të caktuar nga të gjithë trashëgimtarët ligjorë ose testamentarë, sipas rastit.

Në rastet e shkatërrimit total të banesave, subjekti do të kompensohet në vlerën 100%, por pa tejkaluar sipërfaqen, bazuar në normativat e strehimit të Entit Kombëtar të Banesave.

Në të gjitha rastet e tjera të dëmeve pasurore, kompensimi do të jetë 50% e shumës së preventivit të dëmeve.

Afati maksimal për funksionimin e Komisionit për Vlerësimin e Dëmeve, sipas pikës dhjetë të projektvendimit, është 20 ditë.

Pika njëmbëdhjetë e projektvendimit liston në mënyrë të detajuar listën e dokumentacionit vërtetues për dhënien e kompensimit financiar për dëmet. Lista e plotë do të bëjë të mundur dhënien e kompensimit financiar subjekteve të dëmtuara, duke shmangur çdo lloj abuzimi. Duke marrë në konsideratë faktin se në vendin tonë, procesi i legalizimit të objekteve nuk ka përfunduar ende, në listë është parashikuar të pranohet certifikata e pronësisë, e në mungesë të saj "*...çdo dokument tjetër i vlefshëm për vërtetimin e pronësisë mbi objektin ndërtimor të dëmtuar*".

Krahas afateve për ngritjen e komisioneve dhe përfundimit të punës prej tyre, në pikën dymbëdhjetë të projektvendimit përcaktohet një afat maksimal nga ndodhja e fatkeqësisë deri në daljen e vendimit përfundimtar për kompensimin e dëmit, i cili është 45 ditë. Ky përcaktim do të bëjë të mundur shmangien e vonësive të komisioneve dhe kompensimin e subjekteve të dëmtuara në një kohë sa më të shkurtër.

Në pikën trembëdhjetë të projektvendimit përcaktohet çfarë ndodh në rastet kur subjektet përfituese kanë sigurim jete dhe/ose prone. Njësia e vetëqeverisjen vendore bën verifikime, pranë të gjitha kompanive të sigurimit, për masën e kompensimit që kanë përfituar subjektet e dëmtuara dhe bën kompensimin e subjektit deri në masën që do të përfitonte, bazuar në vlerësimin e dëmeve. Ky përcaktim është përfshirë për të shmangur trajtimin e pabarabartë të një subjekti që ka sigurim jete apo prone dhe mund të përfitojë më pak nga kompania e sigurimit, në raport me një subjekt tjetër, i cili nuk e ka sigurimin e jetës apo pronës. Në çdo

---

Relacion shpjegues për projektvendimin "Për përcaktimin e masës së kompensimit të dëmeve, procedurave, afateve, strukturave shtetërore përgjegjëse për vlerësimin e dëmeve, si dhe të pasurive të subjekteve që kompensohen për dëmet që shkaktohen si pasojë e një fatkeqësie."

rast masa e përfitimit për subjektin e kategorisë së parë nuk do të tejkalojë masën që subjekti do të përfitonte në rast se nuk do të kishte sigurim jete dhe/ose prone.

Pika katërbëdhjetë e projektvendimit trajton situatën kur bashkia, ku ka ndodhur fatkeqësia, ka pamjaftueshmëri fondesh për kompensimin financiar të subjekteve të dëmtuara dhe referon në ligjin nr. 45/2019 "Për mbrojtjen civile", ku ndër të tjera, përcaktohet se "3. Në rast se bashkitë nuk kanë fonde të mjaftueshme për kompensimin, atëherë i planifikojnë ato për vitin pasardhës, deri në masën e kompensimit të subjekteve të dëmtuara.

4. Në rast se vlera e kompensimit tejkalon 8 % të buxhetit të bashkisë, KMC-ja vendos që kompensimi të kryhet nga AKMC-ja."

Sipas projektvendimit, në pikën pesëmbëdhjetë përjashtohen nga kompensimi financiar për dëmet e shkaktuara, si pasojë e një fatkeqësie, të gjithë subjektet e dëmtuara, kur kompensohen sipas pikës 5, të nenit 41, të ligjit 45/2019 "Për mbrojtjen civile", e cila përcakton se "Në çdo rast, kur shpallet gjendja e fatkeqësisë natyrore, kompensimi mund të bëhet me vendim të veçantë të Këshillit të Ministrave, me propozim të ministrit".

Pika gjashtëmbëdhjetë përjashton nga kompensimi financiar të gjitha subjektet e dëmtuara të cilat përfitojnë nga programet e Rindërtimit. Ky përcaktim do të shmangë çdo mundësi keqinterpretimi për rastet e subjekteve të dëmtuar nga tërmeti i 26 nëntor 2019, të cilët përfshihen në një program, zbatimi i të cilit do të fillojë në një datë më të mëvonshme se hyrja në fuqi e këtij vendimi.

Në projektvendim, nëpërmjet një dispozite tranzitore, është përcaktuar që kërkesat dokumentacioni i dërguar në Agjencinë Kombëtare të Mbrojtjes Civile për kompensimin e dëmeve të shkaktuara si pasojë e një fatkeqësie, para hyrjes në fuqi të këtij vendimi, do të trajtohet sipas vendimit nr. 329, datë 16.5.2012 "Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore", kjo pikë në projektvendim është vendosur për arsyen se momentalisht AKMC-ja administron kërkesa/dokumentacion për kompensim dëmi si pasojë e fatkeqësive natyrore, këto kërkesa kanë ardhur në zbatim të VKM nr. 329, datë 16.5.2012 dhe këto kërkesa duhet të trajtohen sipas kriterëve të akteve ligjore nënligjore që ishin në fuqi në kohën e ndodhjes së fatkeqësisë.

Projektvendimi shfuqizon vendimin nr. 329, datë 16.5.2012, të Këshillit të Ministrave, "Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore".

## **VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E AKTIT**

Për zbatimin e këtij vendimi do të ngarkohen institucionet dhe strukturat qendrore dhe vendore të mbrojtjes civile.

---

Relacion shpjegues për projektvendimin "Për përcaktimin e masës së kompensimit të dëmeve, procedurave, afateve, strukturave shtetërore përgjegjëse për vlerësimin e dëmeve, si dhe të pasurive të subjekteve që kompensohen për dëmet që shkaktohen si pasojë e një fatkeqësie."



## **VIII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT**

Ky projektvendim është hartuar nga Ministria e Mbrojtjes dhe Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile.

Projektvendimi do të dërgohet për mendim pranë Ministrisë së Financave dhe të Ekonomisë, Ministrisë së Brendshme, Ministrisë së Drejtësisë, Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural.

## **IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE**

Efekte financiare të këtij projektvendimi do të mbulohen nga vetë bashkitë, nëpërmjet fondit të dedikuar për mbrojtjen civile, nga buxheti i shtetit.

**MINISTRI I MBROJTJES**

**Olta Xhaçka**